



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
KËSHILLI I QARKUT BERAT

Nr. 152/13 Prot.

Berat, më 08.02.2023

VENDIM

Nr. 4, Datë 08.02.2023

PËR
KRIJIMIN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR TË VLERËSIMIT TË FIGURAVE TË
QARKUT BERAT

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Kreu XIII "Përbërja, krijimi, mënyra e organizimit dhe kompetencat e këshillit të qarkut", neni 77 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit të qarkut", gërmat "a" dhe "II", Ligjit nr. 112/2013 "Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet, Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kreu III "Procedurat e dhënies së Dekoratave, Titujve të Nderit, Medaljeve ose Titujve Vendorë të Nderit", neni 17 "Komisioni Këshillimor" pika 1,

VENDOSI:

1. Të krijohet Komisioni Këshillimor i Vlerësimit të Figurave të Qarkut Berat të përbërë nga 5 persona, si më poshtë vijon:
 1. Jmer Kodha
 2. Shpetim Nushari
 3. Syrja Ormënj
 4. Besjona Lraj
 5. Arrian Adilaj
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni Këshillimor pranë Qarkut Berat.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 78 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

KRYETAR

Donald MOLISHTI

Këshilltar gjithsej: 18

Morrën pjesë në votim: 10

Votuan Pro: 10



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT BERAT
SEKTORI JURIDIK ,BURIMEVE NJERËZORE STATISTIKËS DHE INFORMIMIT

Berat më 01/02/2023

RELACION SHPJEGUES MBI KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT
KËSHILLIMOR TË VLERËSIMIT TE FIGURAVE

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore “Kreu XIII”Përberja ,Krijimi,Mënryra e Organizimit dhe Kompetecat e Këshillit të Qarkut”, neni 77 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit të Qarkut ”,germa “ll” parashikohet që ” **Keshilli i Qarkut jep tituj nderi dhe stimuj**”

Ligjit nr.112/2013”Për Dekortata ,Titujt e Nderit ,Medaljet,Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar me ligjin nr.10/2015,datë 19.02.2015)

Në nenin 15 “Autoriteti përgjegjës”parashikohet që :“**Këshilli i Qarkut është Autoritet përgjegjës për dhënien e titujve vendor të nderit**”

Në nenin 17 “Komisioni Këshillimor”,pika 1 parashikohet që: “**Çdo autoritet përgjegjës për dhënien e Dekoratave ,Titujve të Nderit ,Medaljet,Titujtve Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë krijon një Komision Këshillimor të përbërë prej 5 anëtarësh ,ku tre anetar duhet të jenë punonjës në varësinë e tij dhe dy anëtar të jenë personalitete të jashtëm**”

VKM nr.861,datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e Komisioneve Këshillimor dhe dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë”.

Kreun I,pika 2 parashikohet që :” Komisioni ngrihet me urdhër të titullarit të autoritetit përgjegjës ,çdo fillim viti kalendarik”

Rregullore e Komisionit Këshillimor të Vlersimit të Figurave, miratuar me vendim nr 10 .datë 15.07.2015 ,dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me nr Prot 649/1.

Kreu III Komisioni Këshillimor ,neni 9 ,pika 1 parashikohet që:

“Autoriteti përgjegjës për dhënien e titullit të nderit krijon pranë tij një Komision Keshillimor të përbërë prej 5 anëtarësh ,ku tre anëtar duhet të jenë punonjës në varësinë e tij dhe dy anëtar të jenë personalitete të jashtëm të cilët zgjidhen me propozim të anëtarve të Këshillit të Qarkut.”

Jurist

Syrja Ormënaj

Këshilli i Qarkut Berat, Blvd.”Republika”Tel/Fax: +355 (032) 234283, Web: www.qarkuberat.gov.al
E-mail:info@qarkuberat.gov.al